

# Mire se ardhët në Mbretërin e Bashkuar



## Prindërimi në Mbretërin e Bashkuar

(\*Prindërimi = procesi i rritjes së një fëmije, nga prindi)



Të gjithë prindërit duan që fëmijët e tyre të jenë të sigurt, të shëndetshëm dhe të lumtur, me mundësi për të ardhmen e tyre. Por ata përballen me shumë sfida në një vend të ri, ku ka ligje të ndryshme, sisteme të ndryshme, pritismeri të ndryshme dhe natyrisht një gjuhë tjetër. Kjo broshurë jep një informacion të rëndësishëm rreth rritjes së një fëmije në Mbretërinë e Bashkuar. Ajo prek sistemin arsimor, për t'ju ndihmuar të mbështesni, mësimin dhe të ardhmen e fëmijës tuaj. Ajo prek disa nga ligjet e hartuara për të mbrojtur fëmijët nga dhuna fizike dhe emocionale, të cilat ndikojnë në mënyrën se si prindërit do të mbikëqyrin dhe dispiplinojnë fëmijët e tyre.

Ky informacion u perzgjodh nga njerëz që kanë kërkuar azil në Mbretërinë e Bashkuar, bazuar në atë që ata do të kishin dashur të dinin, në momentin e pare, që ata ndodheshin këtu. Duke e pasur kete informacion me herët, mund të ndihmojë në parandalimin e problemeve që lindin, sepse ajo që duket normale për ju, mund të krijojë probleme këtu.

### Shkuarja në shkollë

Sipas ligjit në Mbretërinë e Bashkuar, fëmijët duhet të ndjekin arsimin me kohë të plotë midis moshave 5 dhe 16, dhe fëmijët mbi 16 dhe deri në 18 duhet të ndjekin një formë të arsimit ose trajnimit. Nga prindërit kërkohet me ligj që të sigurojnë që fëmija i tyre të shkojë në shkollë. Nuk është zgjidhje. Të mungoj në shkollë, do të thotë që një fëmijë mund të mbetet prapa në mësim. Ju nuk duhet ta mbani fëmijën në shtëpi, përveç rastit kur ka një arsye të fortë dhe e keni njoftuar shkollën. Në të kundërt, prindërit mund të gjobiten ose të lëshohet urdhër gjykatë. Shkollat monitorojnë nga afër frekuentimin, kështu që është me rëndësi që të telefononi shkollën deri në 8.30 për të shpjeguar, pse fëmija juaj nuk mund të shkojë në shkollë. Më shumë informacion gjeni në

<https://www.gov.uk/browse/childcare-parenting/>

[schools-education](https://www.gov.uk/browse/childcare-parenting/schools-education)

### Mbrojtja e fëmijëve nga dhunimi fizik dhe emocional ('Mbrojtja')


Roli që luajnë autoritetet lokale në jetën e një fëmije në Mbretërinë e Bashkuar, mund të jetë krejt i ndryshëm me vendin tuaj. Shumë njerëz i shohin ata, shumë më të përfshirë në jetën e një fëmije, dhe me më shumë fuqi për të ndërhyrë, kur besojnë se një fëmijë rrezikon të lëndohet. Prindërit janë përgjegjës për ti siguruar fëmijëve të tyre siguri dhe mirëqënie, por Autoritetet Lokale gjithashtu kanë një detyrë ligjore të mbrojnë dhe promovojnë mirëqenien e fëmijëve në zonën e tyre. Vizitorët e Shëndetit, Mësuesit, Punonjësit Socialë, Këshilli Vendor dhe Policia të gjithë luajnë një rol në identifikimin dhe mbështetjen e fëmijëve të konsideruar në rrezik. Ata monitorojnë për shenja të abuzimit të fëmijëve ose neglizhencës, të tilla si dëmtime të pashpjegueshme, shqetësime emocionale, të qenit i papastër ose i uritur ose të mbetet pa mbikëqyrje. Nëse një shkollë ose një vizitor i shëndetit, ose një anëtar i publikut raporton shqetësimin në lidhje me sigurinë dhe mirëqenien e një fëmije tek policia ose punonjësit socialë, ata duhet të hetojnë. Ata do të takojnë prindërit për të shqyrtuar këto shqetësime dhe të diskutojnë nëse duhen bërë ndonjë ndryshim për të evituar rrezikun.

Por nëse ata besojnë se fëmija është ende në rrezik, ata kanë fuqinë ligjore që ta largojnë fëmijën nga familja dhe ta vendosin atë në kujdesin e këshillit lokal.

Pra, ligji i MB për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe neglizhenca, ndikon në atë që, nga sa afër pritet, që prindërit të mbikëqyrin një fëmijë, dhe si i dispiplinojnë ata..

### Mbikëqyrja e fëmijëve

Nëse një prind mbikëqyr fëmijën në mënyrë që t'i vendos ata në rrezik, ata do të konsiderohen neglizhentë. Për shembull, një fëmijë i pa mbikëqyrur rrezikon të lëndohet nëse nuk e njuh rrezikun, nuk e di se si ta shmangë atë ose çfarë të bëjë në raste urgjente. Udhëzimet Kombëtare deklarojnë se foshnjat dhe fëmijët shumë të vegjël nuk duhet të lihen vetëm, madje as për 15 minuta. Fëmijët nën 12 vjeç nuk kanë pjekurinë sa të lihen vetëm, ose të kujdesen për fëmijë më të vegjël, ose të gatujnë vetë pa mbikëqyrjen e të rriturve. Fëmijët nën 16 vjeç nuk duhet të lihen vetëm gjatë natës. Ligji nuk jep një moshë të saktë kur një fëmijë mund të lihet i vetëm në mënyrë të sigurt, pasi pjekuria e fëmijëve është në shkallë të ndryshme. Një prind duhet të marrë parasysh pjekurinë e fëmijës së tyre dhe të largojë rreziqet, të tilla si thika të mprehta ose një dritare e hapur nga e cila një fëmijë mund të bjerë jashtë, dhe të sigurohet që ata të dinë se çfarë të bëjnë në raste urgjente.



Fëmijët e vegjël gjithashtu duhet të mbikëqyrin kur luajnë jashtë, si psh në një park. Shkollat fillore presin që prindërit ta shoqërojnë fëmijën e tyre në shkollë dhe t'i marrin nga shkolla. Çdo shkollë ka politikën e vet për të konsideruar se kur është e sigurt që një fëmijë të jetë i pashoqëruar. Do të duhet të informoni shkollën nëse vendosni që dikush tjetër do të marrë fëmijën tuaj nga shkolla, pasi shkollat nuk lejojnë kurrë, që një fëmijë të largohet me një të huaj. Kjo mund të jetë në kundërshtim me atë që është normale në vendin tuaj, ku fëmijëve mund t'u jepet përgjegjësi në një moshë më të hershme. Por është shumë e rëndësishme të kuptohet ndryshimi me Mbretërinë e Bashkuar dhe pasojat e saj për prindërit.

Më shumë informacion do të gjeni në

<https://www.nspcc.org.uk/keeping-children-safe/>

### Disiplinimi i fëmijëve

Si në shumë vende të botës, qëndrimet ndaj përdorimit të ndëshkimit fizik për të dispiplnuar fëmijët, si psh goditja me shpullë, kanë ndryshuar në Mbretërinë e Bashkuar. Tani shihet si abuzive dhe e dëmshme. Mesazhi është i thjeshtë **prindërit nuk duhet të përdorin ose të kërcënojnë të përdorin, ndonjë formë të ndëshkimit fizik për të dispiplnuar fëmijët e tyre.**

Asnjë formë ndëshkimi nuk duhet ta lërë një fëmijë me ënjtje, gërvishtje, prerje ose skuqje të lëkurës.

Autoritetet lokale duhet të hetojnë çdo raport që ai merr në lidhje me një fëmijë të dhunuar. Nëse ata besojnë se fëmija ka rrezik të abuzimit të mëtejshëm ata mund ta largojnë fëmijën, dhe ta lënë në kujdestarinë e dikujt tjetër. Kjo vecanërisht do të ndodhë nëse fëmija është dhunuar me mjete si lugë, rrip mesi ose këpucë.





Nëse dikur mbështeteshit në përdorimin e ndëshkimit fizik për të menaxhuar sjelljen e fëmijës tuaj, tani që jeni në Mbretërinë e Bashkuarë, ekziston mbështetje për të ndihmuar prindërit të kuptojnë dhe të përdorin metoda alternative. Mund të kontaktoni ose të kërkonit të drejtoheni te Ekipi i Ndhimës së Hershme të Këshillit tuaj lokal. Ata do t'ju shpjegojnë metoda që përfshijnë mësimin dhe shpërblimin, në vend të ndëshkimit fizik.



Ata kryejnë seminare për prindërit dhe madje mund të vijnë në shtëpinë tuaj për t'ju ndihmuar të praktikoni metodat.

Për më shumë informacion kërkonit në <https://learning.nspcc.org.uk/safeguarding-child-protection/early-help-early-intervention> dhe <https://www.familylives.org.uk/advice/primary/behaviour/positive-discipline/>

Mund të jetë e dobishme që të konsideroni se fëmijët që kanë përjetuar trauma, të tilla si lufta dhe humbja e shtëpisë së tyre, mund të preken emocionalisht.

Kjo mund të çojë në sjellje që është veçanërisht e vështirë dhe sfiduese për prindërit. Të rriturit gjithashtu preken nga frika dhe humbja, dhe janë edhe më shumë të stresuar dhe të shqetësuar, ndërsa presin një vendim për kërkesën e tyre si azil kërkues. Ata nuk lejohen të punojnë gjatë kësaj kohe, që do të thotë që prindërit mund të jenë bashkë në shtëpinë 24/7. E gjithë kjo mund të çojë në situata të tensionuara në shtëpi, dhe prindërit mund të reagojnë më shpejt ndaj gjërave dhe me më shumë zemërim, se zakonisht. Personat që kanë kaluar përvojën tuaj, rekomandojnë të krijoni lidhje me rrjetet sociale lokale dhe aktivitetet që ju largojnë nga shtëpia dhe mund t'ju ndihmojnë të menaxhoni stresin në jetën tuaj. Këtë informacion mund ta gjeni në Paketën e Mirëseardhjes, të siguruar nga ofruesi juaj i strehimit dhe në faqen e internetit të Partneritetit për Migracionin.

Prindërit e shqetësuar për ndikimin e traumës tek fëmija i tyre mund të kontaktojnë linjën telefonike falas për Young Minds për këshilla konfidenciale dhe profesionale. Kërkonit në <https://youngminds.org.uk/find-help/for-parents/parents-helpline/>

### Krijimi i një marrëdhënie me shkollën dhe Punonjësit Socialë

Shkollat duhet të monitorojnë fëmijët për shenja të abuzimit dhe neglizhencës. Mësuesve u kërkohet të regjistrojnë çdo shqetësim në një sistem qendror kompjuterik. Shkolla do të kontaktojë prindërit për të diskutuar shqetësimet e vërejtura ose të përsëritura, dhe të përpiqet të zbulojë se çfarë po ndodh. Nëse prindërit janë duke hasur vështirësi ose nuk e kuptojnë atë që kërkohet në Mbretërinë e Bashkuarë, shkolla mund të ofrojë mbështetje nga një Ekip i Ndhimës së Hershme, i cili do të krijojë një plan mbështetjeje për familjen. Por nëse prindërit nuk komunikojnë me shkollën ose nuk marrin ofertën mbështetëse, shkolla do t'i referojë shqetësimet e tyre tek një Punëtor Social.

Disa çështje do të kalojnë në referim të menjëhershëm nga shkolla te një Punonjës Social. Këto janë shqetësime që lidhen me abuzimin e fëmijëve. Nëse një fëmijë thotë se "nëna ime më goditi" ose "ajo kërcënoi të më godiste me një lugë", ose fëmija ka një dëmtim ose shenjë për të cilën nuk ka ndonjë shpjegim të arsyeshëm, shkolla ka për detyrë t'i referojë këto tek Punonjësi Social. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme që prindërit të telefonojnë shkollën deri në orën 08.30 për t'i informuar ata për ndonjë dëmtim ose shenjë dhe të shpjegojnë se si ndodhi. Prindërit me anglishte të kufizuar duhet të kërkojnë nga dikush që të ndihmojë me mesazhin.

Punonjësi Social, nëse është e nevojshme, do të kontaktojë prindërit për të diskutuar shqetësimet dhe të hartojë një plan veprimi për të përmirësuar kujdesin e fëmijës. Mund t'ju duket alarmante, por reagimi më i mirë është të dëgjoni shqetësimet e Punonjësit Social, të jeni të gatshëm t'i diskutoni ato për të zbuluar çdo çështje që mund të sjellë rrezikun e sigurisë së fëmijës dhe të jeni i hapur për të identifikuar rrugët e zgjidhjes. Kjo do të thotë që prindërit duhet të ndryshojnë mënyrën se si i bëjnë gjërat. Prindërit mund të kërkojnë mbështetje profesionale, për t'i ndihmuar ata që të përballojnë këtë sfidë. Por nëse prindërit qëndrojnë të heshtur, Punonjësi Social nuk mund të kryejë sic duhet detyrën e tij për mbrojtjen e fëmijëve, që do të thotë se ai është i bindur se fëmijës nuk i kanoset ndonjë rrezik. Nëse nuk mund të hetojnë, ata nuk mund të eliminojnë rreziqet ndaj fëmijës, kështu që ka shumë të ngjarë të duhet të kërkojnë largimin e fëmijës nga familja. Natyrisht që askush nuk dëshiron që kjo të ndodhë. Sido që të jetë shqetësimi, ndërhyrja gjithmonë do të përshkallëzohet nëse prindërit nuk përfshihen në diskutime ose pranojnë oferta të mbështetjes ose të ndryshojnë mënyrën se si i bëjnë gjërat.

### Marrëdhëniet midis prindërve në shtëpi




Fëmijët mund të pësojnë dëmtime emocionale, serioze dhe afatgjata, nëse janë dëshmitarë ose dëgjojnë dhunë, ose abuzime të llojeve të tjera, që ndodhin midis prindërve të tyre, edhe pse fëmija nuk është në vetvete objektivi i këtij abuzimi. Provat tregojnë se Dhuna në Familje mund të ndikojë seriozisht në jetën e tyre, veçanërisht nëse e kanë përjetuar në një moshë shumë të re. Mund të ndikojë në aftësinë e tyre për t'u përqëndruar dhe përparuar në shkollë, dhe të çojë në depresion dhe çrregullime të të ngrënit dhe sjellje më agresive ose të mbylljen në vetvete. Fëmijët gjithashtu kanë më shumë të ngjarë të preken nga dhuna kur të rriten, si autorë dhe viktime. Abuzimi në familje është e kundër ligjshme. Nëse policia ose punonjësit social hetojnë raportet e abuzimit në familje, dhe gjejnë një fëmijë që jeton atje, ata mund të vendosin që njëri prej prindërve duhet të largohet nga shtëpia për të parandaluar rrezikun e mëtejshëm të dëmtimit të fëmijës, ose ta largojnë fëmijën dhe ta vendosin në kujdesin e këshillit lokal.

### "Syneti" i femrës

Është e paligjshme të rregulloni, performoni, ndihmoni ose inkurajoni "Synetin" e femrave, e njohur në Mbretërinë e Bashkuarë si Gjymtimi i Organeve Gjenitale Femerore. Kjo konsiderohet si një formë e abuzimit të fëmijëve pasi shkakton një dëmtim të gjatë fizik dhe emocional për fëmijën. Dënimi është deri në 14 vjet burg.

### Fëmijët dhe makinat

Për të mbrojtur shëndetin e tyre, është e paligjshme të pini duhan ose të lejoni pirjen e duhanit nëse ka një fëmijë nën moshën 18 vjeç në makinë. Foshnjat dhe fëmijët nën moshën 12 vjeç ose nën 125 cm të gjatë duhet të jenë në një sedilje të përshtatshme për fëmijë. Përgjithësisht bëhen vetëm në raste urgjente, një udhëtim i papritur në një distancë të shkurtër ose nëse një shofer taksie nuk ofron sedilje për fëmijët.



## Ndihmoni fëmijën tuaj të qëndrojë brenda ligjit



Prindërit duhet të sigurojnë që fëmija i tyre e di se si ligji në Mbretërinë e Bashkuar ndryshon, nga ato që kanë përdorur më parë. Shpjegoni atyre se është e paligjshme për këdo nën 18 vjeç që të blejë alkool ose cigare. Dhe është e paligjshme për çdo të rritur të blejë këto për ata. Kushdo që kapet duke përdorur, poseduar ose shitur drogë të paligjshme mund të arrestohet, përfshirë nëse dikush tjetër u kërkon atyre të japin drogë. Është e paligjshme të bësh seks me këdo, mashkull ose femër, i cili është nën 16 vjeç edhe nëse keni pëlqimin e tyre. Seksi me këdo mbi 16 vjeç duhet të jetë me pëlqimin e tyre, përndryshe bëhet fjalë për sulm seksual ose dhunim, për të cilin dënimi mund të jetë deri në 15 vjet burg.

Të rinjtë mund të martohen kur janë 16 vjeç nëse kanë pëlqimin e prindërve të tyre, përndryshe duhet të jenë 18 vjeç.

## Mbroni fëmijën tuaj nga bulizmi, urrejtja dhe abuzimi në internet

Inkurajoni fëmijën tuaj të ndajë ndonjë shqetësim për mënyrën e trajtimit të fëmijëve të tjerë në shkollë. Nëse një fëmijë tjetër është në shënjestër të tyre, për t'i lënduar ata fizikisht ose emocionalisht, kjo quhet "bulizëm". Nëse ata janë në shënjestër për shkak të racës ose fesë së tyre, kjo quhet "Urrejtje". Të dy dëmtojnë mirëqenien e fëmijës dhe duhet të ndalen. Ju nuk duhet të përpiqeni ta zgjidhni vetë këtë shqetësim, duke iu afruar fëmijës tjetër ose prindërve të tij.



Ju duhet të bisedoni me

Mësuesin e klasës për t'i bërë ata të vetëdijshëm për çfarë po ndodh dhe të diskutoni se çfarë veprimesh mund të ndërmerret shkolla për të parandaluar që të ndodhë përsëri. Të gjitha shkollat kanë një politikë sjelljeje dhe një detyrë të kujdesit për fëmijën tuaj. Nëse abuzimi përsëritet, kërkon që të flisni me drejtorin e shkollës. Ju gjithashtu mund të flisni me policinë, veçanërisht për abuzime më serioze siç janë dhuna, vjedhja, frikësimi, ngacmimi dhe krimi i urrejtjes. Për më shumë këshilla se si prindërit mund ta mbrojnë fëmijën e tyre nga bulizmi kërkon në

<https://www.bullying.co.uk/bullying-at-school/advice-on-contacting-your-child-s-school-about-bullying/>



Fëmijët kanë akses në internet në një moshë të re dhe mësojnë shpejt të hulumtojnë në internet dhe aplikacionet e mediave sociale, përmes telefonave ose pajisjeve të tjera dixhitale. Ata mund të jenë në rrezik nga ngacmimi dhe abuzimi në internet dhe nga qasja në materiale të papërshtatshme dhe të dëmshme. Ky është një shqetësim i vërtetë për të gjithë prindërit dhe mund të ketë një ndikim serioz në besimin, vetëvlerësimin dhe shëndetin e një fëmije. Përsëri, inkurajoni fëmijën tuaj të ndajë shqetësime me ju. Ekzistojnë organizata që ofrojnë këshilla praktike që prindërit të menaxhojnë këto rreziqe dhe të raportojnë incidentet në mënyrë që të merren masa për të parandaluar që të ndodhin përsëri. Kërkon në <https://www.bullying.co.uk/cyberbullying/>

## Të drejtat e prindërve dhe fëmijëve

Nëse një autoritet lokal po heton shqetësimet në lidhje me sigurinë e një fëmije, të dy, si prindërit dhe fëmija kanë të drejta. Profesionistët do të flasin me prindërit dhe fëmijën. Ata do të përpiqen të zbulojnë se çfarë dëshiron fëmija, pasi fëmija ka të drejtë të dëgjohet, në çdo vendim mbrojtjeje të marrë për të ardhmen e tij. Prindërit kanë të drejtë të kërkojnë një përkthyes për të siguruar që ata e kuptojnë informacionin që



u është dhënë atyre

dhe mund të shprehen qartë. Nënshkruani dokumentet vetëm nëse dini kuptimin e tyre dhe pasojat. Nëse bëhet një rast mbrojtjeje, prindërit kanë të drejtë të përfaqësohen me ligj nga një avokat i Ligjit Familjar. Mund të jetë pa ndonjë kosto kur ofrohet nga Skema e Ndihmës Juridike, nëse jeni në mbështetje të Azilit, nga Zyra e Brendëshme (Home Office). Punonjësi Social duhet t'ju jap informacione në lidhje me këtë dhe gjithashtu mund të merrni informacione dhe këshilla falas, të paanshme, të pavarura dhe konfidenciale nga Zyra e Këshillimit të Qytetarëve që ndodhet pranë vendbanimit tuaj.



*Detaje të plota për të gjitha çështjet e përfshira në këtë broshurë mund të gjenden në faqen e internetit "Prindërimi në Mbretërinë e Bashkuar" burimi elektronik në North East Migration Partnership. <https://www.nemp.org.uk/>*